

ÇËSHTJE TË IDENTITETIT DHE TË GLOBALIZIMIT NË ETNOLOGJINË BASHKËKOHORE IDENTITY AND GLOBALIZATION ISSUES IN CONTEMPORARY ETHNOLOGY

LUMNIJE KADRIU

Instituti Albanologjik Prishtinë, Dega e Etnologjisë, Eqrem Çabej nn, Prishtinë Kosovë
Email: lume70@hotmail.com

Abstract.

Twentieth century was marked by lots of changes in economic, social and political development and among most relevant achievements is considered formation of states and their identity. Ethnology, having as study object this particular social structure, which was defined as people, played the relevant role in constructing of these identities. In present days, in 21st century in the center of contemporary ethnology we pronouncedly again find the issue of cultural, ethnic and national as well as regional identities in inequable and recently created realities as a result of the cultural globalization process flow. Globalization process as an expansion of West European cultural values into other worldwide cultures and local cultural responses toward it, are also prevailing topics and approaches in ethnology. This paper is focused in some theoretical approaches, such as essentialist and discursive, regarding these notions and their reflection in Albanian culture and identity.

Key words: Identity, ethnicity, regional, local, national, globalization

Identiteti dhe identiteti kulturor

Meqë identiteti është i lidhur me qeniet njerëzore dhe pozitën e tyre në shoqëri, është i lidhur me mënyrën se si njeriu e sheh veten në një shoqëri dhe si e sheh shoqëria atë, edhe me këtë çështje përveç etnologëve u morën autorë të disiplinave të ndryshme të shkencave shoqërore dhe natyrisht kësaj iu qasën nga aspekte të ndryshme. Në historinë e etnologjisë shohim gjatë periudhave të ndryshme të kenë dominuar njëra apo tjetra qasje (esencialiste apo diskursive), gjithnjë e më fuqishëm duke u aktualizuar kjo e fundit.

Ngushtë e lidhur me këto çështje është edhe identiteti kulturor i cili edhe si definicion merr konotacione herë më të ngushta e herë më të gjera, zakonisht i

shoqëruar edhe me nocione të tjera gjeografike, hapësinore e mendore, siç janë edhe regjioni, lokaliteti, apo etniteti. Prandaj identiteti kulturor si nocion, në rastin tonë, do të bëhet më i qartë me ndihmën e definimit të etnitetit por edhe regionalizmit.

Etniteti

Për arsye të zhvillimeve të ndryshme historike, politike e ekonomike të shteteve të Evropës, me anë të analizave më të hollësishme mbi etnitetin, u bë e mundur të shpjegohej dhe të bëhej edhe më e qartë çështja se pse ndjenja e përkatësisë e gjithë popullit të një shteti nuk lidhej gjithnjë me të njëjtën fuqi me shtetin e caktuar dhe pse konstruktimi i ndjenjës së përbashkët nuk është njësoj i fuqishëm, nuk perceptohej dhe pranohej njëjtë nga të gjitha grupet e definuara etnike. Natyrisht se kjo lidhej me krijimin e shteteve e të kombeve dhe të ashtuquajturave shtetekombe në shekullin XIX, të cilat, në të shumtën, nuk ishin në përputhje të plotë me gjendjen e popullatës dhe identiteteve të tyre që ato përfshinin në territoret e tyre.

Në kuadër të këtyre studimeve etnike hyjnë edhe studimet e pakicave kombëtare jashtë kufijve të shteteve amë dhe të diasporave në vende të ndryshme, si rezultat i krijimit të shteteve të reja dhe mërgatave të popujve në periudha të caktuara historike, e sidomos si rezultat i mobilitetit në kohët e sotme si rrjedhojë e procesit të globalizimit, të cilat kryesisht identifikohen etnikisht. Te këto grupe edhe është shumë më evidente, më e dukshme, prania e identiteteve të shumta dhe përzgjedhja e ndonjërit prej këtyre identiteteve, varësisht nga situata, konteksti në të cilën është i vendosur akteri (Weedon 2004: 20; Grbic 1994: 46; Okamura 1981: 452-463).

Regjionalizmi

Ndër rezultatet domethënëse të studimeve të etnologjisë tradicionale dhe etnografisë si pjesë e saj,

është edhe definimi i krahinave etnografike, *si njësi gjeografike me karakteristika të veçanta kulturore*. Këto krahina etnografike, më të vogla a më të mëdha, të gjitha ishin pjesë e formimit kombëtar/etnik, si të popujve të tjerë, ashtu edhe të popullit shqiptar. Po ajo që u tha për krahinat etnografike, me një intensitet shumë të theksuar dhe për arsye pothuajse të ngjashme, po ndodh edhe në ditët e sotme dhe më së shpeshti shpjegohet si rrjedhojë e procesit të globalizimit. Kështu, sot në etnologji, është aktuale të flitet për regionet dhe regjionalizimin.

Kur në Evropë gjatë shekullit XIX u krijuan shumica e shteteve, pjesëtarë të etnive të ndryshme ngelën brenda kufijve të një shteti, por të shpeshta ishin rastet edhe kur pjesëtarët e një etnie ngelën të ndarë administrativisht në disa shtete. Ky fat i keq i gjeti edhe shqiptarët. Pra, shohim se definimi i parë i përgjigjet, apo i shkon për shtati shumë mirë nocionit të etnitetit, në këtë rast etnisë shqiptare; dhe i dyti nocionit të krahinës etnografike - apo thënë pak më gjerësisht regjionit, me këtë rast identitetit kulturor të shqiptarëve të vendosur në regjione të ndryshme shtetërore dhe/apo krahine etnografike duke marrë parasysh veçoritë e tyre kulturore lokale dhe situatën e veçantë administrative e politike.

Globalizimi kulturor si proces

Mund të thuhet se synim kryesor i secilës shoqëri gjatë gjithë historisë së njerëzimit ishte mirëqenia e saj, vetëpërbushja apo thënë më thjesht jeta e saj e lumtur. Kjo kohëve të fundit synohet të arrihet përmes globalizimit.

Por çka është globalizimi dhe çfarë nevojash theksohen në këtë proces kur është fjala për kulturën?

Shumë studiues e shohin globalizimin si një proces të përhapjes së elementeve kulturore perëndimore në mbarë botën. Është proces i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik, zhvillimin e komunikimit e të medieve dhe natyrisht, si rrjedhojë e këtyre, edhe me konsumimin masiv dhe lëvizjen apo mobilitetin e njerëzve anekënd botës. Duke u nisur nga kjo, për globalizimin është pohuar e vijon të pohohet se rrezikon shkrirjen dhe humbjen e identiteteve kulturore. Është interesant të theksohet se në fakt ky qëndrim ndaj globalizimit si gllabërues i kulturave dhe i identiteteve autentike ka ndryshuar. Shumë antropologë e etnologë në fakt e shohin globalizimin si proces në të cilin "identitetet kulturore prodhohen më parë se viktimizohen" dhe për këtë japin shembuj të shumtë që pasqyrohen në formë të theksimit të vlerave etnokulturore, qoftë materiale, qoftë shpirtërore të manifestuara si fenomen i prodhimit të lokale, i krijimit të etnopeisazheve, i glocalizimit, e që të gjitha paraqesin një formë të riptencimit të

identitetit kulturor të komuniteteve, kulturave apo etnive përkatëse; të përshtatjes së kulturave lokale në një ambient global; të hyrjes së një dukurie rurale në një mjedis urban.

Pra, shohim se ajo që, në të vërtetë, është duke ndodhur në botë është gërshetimi i dy tendencave kundërthënëse, por që e plotësojnë njëra tjetrën. Shembull i shkëlqyeshëm i autorit britanik Tomlinson është rijetësimi i veshjes tradicionale Manchuriane nga shekulli XVII deri XVIII në dinastinë Qing, të quajtur *Qipau* që tash shitet në një dyqan ekskluziv të një qendre tregtare në Pekin. Ajo kushton relativisht shtrenjtë, është tejet atraktive, si për kinezët, ashtu edhe për perëndimorët. Tomlinsoni konsideron se këtë veshje kinezet e reja nuk e bartin për ta shprehur identitetin manchurian, por në fakt shprehin një lloj identiteti kinez ... dhe me këtë, sipas tij, argumentohet se globalizimi nuk po e sfidon, por po e promovon një version të ri dhe kompleks të identitetit nacional.

Me këtë rast shohim *rëndësinë e lokaleve në proceset kulturore* dhe arsyeshmërinë se pse kohëve të fundit, me qëllim të definimit sa më të mirë të asaj që është duke ndodhur kulturalisht dhe ekonomikisht në mbarë globin, e që duket të jetë mjaft komplekse, dëgjojmë shpesh të përdoret termi i glocalizimit, të cilin do të provojmë ta shtjellojmë në vijim.

Glocalizimi dhe dukuria e glocalizimit si shprehje e identitetit kulturor

"Globalizimi lind nga dëshira që, nga inventari i elementeve kulturore dhe i elementeve të tjera që përbëjnë një identitet, të zgjedhen ato që konsiderohen karakteristika *burimore* dhe *origjinale* të një grupi të caktuar dhe/ose të një vendi/hapësire e të cilat kombinohen me ato që konsiderohen globale".

Rasti i veshjes tradicionale manchuriane të quajtur *Qipau*, që u përmend më sipër, është një shembull interesant i glocalizimit. Dëgjimi i predikimeve fetare nga një Sikh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përderisa drejton një "Taxi" paraqet edhe një shembull tjetër të glocalizimit, apo një riprodhim të lokale. I tillë është edhe kultivimi muzikës së popullarizuar dhe asaj rock në gjuhë nacionale/dialekte që mundëson një lloj identifikimi nacional, apo edhe më të ngushtë regjional për dëgjuesit. Shembujt, pra, janë të shumtë dhe meqë ata shihen e ndeshen kudo, në kombinimet më të çuditshme, mund të themi se është fjala për një dukuri. Dhe pa dyshim që e tërë kjo ka të bëjë me ndonjë shprehje kulturore, qoftë ajo shprehje individuale, qoftë grupore, lokale, etnike, regjionale a nacionale/shtetërore.

Duke pasur parasysh këtë që u tha, shtrojmë pyetjen nëse ka dukuri të glocalizimit ndër shqiptarë e në Kosovë?! Pa dyshim se ka. Për shkak të situatës politike, sidomos që nga vitet 90, një numër i madh i shqiptarëve të moshave të ndryshme migruan në vende të botës. Kulmi arriti në vitin 1999, kur për shkak të eksodit të shkaktuar nga dhuna serbe, shumë shtete pritën një numër të madh shqiptarësh të Kosovës, familje të tëra shqiptarësh, në mënyrë të organizuar. Kjo rezultoi me ndryshime të shumta edhe në mesin e atyre që mbetën dhe vazhduan jetën këtu, edhe në mesin e atyre që u larguan dhe ruajtën kontaktet me anëtarët e vet apo krijuan kontakte të shumëfishta edhe me të tjerë. Si rezultat i gjithë kësaj, edhe në kulturën tonë paraqiten dukuri të glocalizimit, paraqiten forma të ndryshme të riprodhimit të kulturës shqiptare, apo të “prodhimit të lokales” nëpër shtete të Perëndimit, por ka edhe dukuri të “rikonstituimit të komunitetit dhe traditës” brenda Kosovës.

Një shembull konsekuent i glocalizimit na paraqitet në përgaditjet e ushqimit. Padyshim se kudo në familjet shqiptare (në vend dhe diasporë) vazhdon ruajtja e traditës së të ushqyerit me ushqime tradicionale. Mirëpo, në familjet e tyre padyshim se hynë edhe ushqimet e kulturave të tjera, e sidomos picat dhe makaronat dhe salcat italiane.

Procesin e glocalizimit nëpërmjet ushqimit e shohim të manifestuar qartë edhe në Kosovë. Pas luftës së fundit këtu, nëpër qytetet e ndryshme të botës e edhe në Prishtinë (dhe qytete tjera të Kosovës) shohim një numër të madh të restoraneve që ofrojnë ushqim të përgaditur shpejtë apo, siq është e njohur nëpër botë, “fast food”. Shembullin që më së shpeshti e marrin studiuesit në këtë rast është ai i restoraneve të “Mc Donaldit dhe Coca Colla-ës. Edhe pse ky shembull më i njohur i globalizimit, pra restorani “Mc Donald”, ende nuk ka mbërrirë në Prishtinë, mënyra e të ushqyerit si në një restorant të Mc Donaldit ekziston anë e kënd qytetit të Prishtinës (e edhe qyteteve të tjera të Kosovës). Ofrohen pra, hamburgerë e qebapa, toste e senduiçë për pak minuta pritjeje. Kjo padyshim se shënon edhe plotësimin e një nevoje, e një kërkese që paraqitet si plotësim në mënyrën e jetesës më dinamike, më urbane. Si dukuri të globalizimit, të lidhura me ushqimet dhe mënyrën e të ushqyerit, mund të konsiderojmë edhe prezencën e shumë restoraneve nacionale nga kulturat e tjera të botës, siq janë restorantet kineze, Thai dhe ofrimi i ushqimeve të ndryshme evropiane si italiane e franceze. Të gjitha këto pra u futën në kuadër të këtij procesi.

Po e njëjta gjë po ndodh edhe në anën e kundërt, me tendencën e theksimit të “lokales”. Kjo po ndodh me

anë të adaptimit të të ofruarit të ushqimit tradicional në një mënyrë moderne, me anë të pranisë së shumë furrave e restoraneve në të cilat ofrohet ushqimi i llojllojshëm tradicional, etnik. Në këto furra përkatëse në të cilat ofrohen lloje të shumta të ushqimeve dhe ambëlësirave tradicionale krahas atyre internacionale na paraqitet edhe mbishkrimi dygjuhësor i tyre (shqip e anglisht). Aty shitet flia dhe mantia, buka e misrit e gatuar në mënyrë tradicionale, e shumë lloje të tjera krahas “mafinave e doughnats-ave” amerikan si dhe ambëlësirave të ndryshme nacionale e internacionale.

Shumë restorane përveç që servirin gatesa tradicionale janë të dekoruara në mënyrë dominante apo pjesërisht me elemente të kulturës materiale etnike (veshje të ekspozuara në mure, fotografi me motive etnokulturore, enë e orendi etj., instrumente etnomuzikore si lahuta e çiftelia etj.) Në shfaqje çdo herë e më të madhe viteve të fundit na dalin restorantet më në periferi të qytetit, në të cilat mund të themi se shohim të reflektohet jo vetëm prodhimi i lokales me anë të objekteve, artefakteve, të veçuara por edhe përpjekjet për një riprodhim peizazhi kulturor apo *etnopsazhi*, siq e quan Appadurai, meqë bëhen përpjekje të qarta për një kontekstualizim të ambientit nga jeta tradicionale me anë të vendosjes së objekteve të ndryshme nga jeta ekonomike siq janë qerre të drurit, karroca pune, gurë mullinjësh, koshere bletësh, etj. apo edhe të krijimit të këndeve me një etno-atmosferë ku shihet oxhaku, zjarri, saçi, maxhja. Madje si risi na paraqiten edhe gratë e veshura në mënyrë tradicionale të cilat shihen duke përgatitur ushqimin aty për aty. Pra është një ri-prodhim i një jete tradicionale, pune tradicionale, që së bashku me të gjitha elementet, zgjojnë ndjenjat, gjallërojnë imagjinatën dhe kujtesën, forcojnë ndjenjën e përkatësisë. Pra, etnoelementet e përdorura në dekorimin e restoraneve dhe lokaleve të ndryshme si dhe oborreve të restoraneve në fjalë reflektojnë simbolizëm. Ato simbolizojnë pjesë të traditës, trashëgimi, identitet. (sado të fragmentarizuar qofshin).

Paraqitje të fragmentarizuar të etnoelementeve shohim të paraqesin edhe tekstilet e ndryshme nëpër kafeteritë e ndryshme të Prishtinës, ku shohim funksionin e tyre të ndryshuar krejtësisht, ku roli i tyre pra është më tepër simbolik, ku shohim të gërshetohen në mënyrë shumë interesante mënyra moderne e dëfrimit, kalimit të kohës së lirë, ambientit kryesisht urban, të zbukuar me detaje nga etnokultura si dëshmi e një shijeje të veçantë, shprehjeje estetike të dalluar, e pse jo edhe ndjenjë të një identiteti përkatës.

Por pse ndodhin këto? Për rolin e rëndësishëm të traditave në konstruktimin e identitetit kulturor ka shkruar edhe Lauri Honko dhe për këtë rast do të theksoja citimin e tij të autorit Shils i cili për pozitën e traditave në modernitet thotë: "qeniet njerëzore nuk mund të mbijetojnë pa tradita edhe pse ata janë aq shpesh të pakënaqur me to"; "traditat janë edhe këmbëngulëse edhe të përçara. Ato, sidoqoftë, mbijetojnë në ndonjë formë. Gjithësecili veprim i yni dhe gjithësecili besim i yni ndikon në fatin e një apo tradite tjetër" Dhe kjo nevojë e njerëzve për t'i gëzuar të mirat e modernitetit dhe për të plotësuar nevojat e identitetit shohim se e gjen mënyrën e vet të shprehjes dhe të plotësimit në këtë apo atë mënyrë. Shohim të na vijnë të gërshetuara mënyra globale e të ushqyerit çdo herë e më të shpeshtë nëpër restorane, si shprehje e mënyrës së jetesës perëndimore, me ushqim tradicional (fli, mantija, long e specia) që në të kaluarën shijoheshin vetëm në një ambient shtëpiak. Përveq kësaj e gjithë kjo reflekton edhe plotësimin i një shijeje, plotësimin e një nevojjeje dhe shprehjeje të identitetit të veçantë.

Mund të përfundojmë se krahas vitalitetit të komunitetit për krijimtari, për rigjetje të mënyrave për t'u spikatur në kontaktet me të "tjerët", për të plotësuar nevojën e identifikimit me të "njejtit", e që kryesisht përshkohet nga një spontanitet, është tejet e nevojshme edhe mbështetja e institucionalizuar e këtij kreativiteti. Kjo mbështetje është e nevojshme në

mënyrë që një shoqëri të vazhdojë të jetë mirë e organizuar dhe të vazhdojë rrugën drejt zhvillimit, duke bërë përzgjedhjet e duhura dhe të qëlluara për riprodhim të traditave, ruajtjen e kultivimin të identitetit kulturor, dhe adaptimit sa më të lehtë të të gjitha këtyre në kërkesat e jetës bashkëkohore, moderne.

Ndërsa sa i përket etnologjisë, këta shembuj paraqesin shembuj ilustrues të vështrimit të çështjeve të identitetit dhe globalizimit në bashkëkohësi dhe mënyrat e ndryshme të perceptimit të dukurive nga studiuesit e shkencave shoqërore në përgjithësi.

Bibliografia

- GRBIC, Jadranka (1994), *Identitet, jezik i razvoj* – Institut za etnologiju i folkloristiku, Zagreb.
- HALIMI-Statovci, Drita (2008), »Nga tradita në modernitet«, "*Koha ditore*", 4 tetor.
- HALL, Stuart (1966), *Introduction: Who Needs "Identity"?* në: "*Questions Of Cultural identity*" të edituar nga Stuart Hall dhe Paul Dugay nga SAGE Publications London, Thousand Oaks, New Delhi.
- OKAMURA, Jonathan Y. (1981), »Situational Ethnicity« në "*Ethnic and Racial Studies*", vol. 4: 452-463.
- XHEMAJ, Ukë (1987), *Rugova*, monografi etnografike, ASHAK, Prishtinë.
- XHEMAJ, Ukë (2005), »Etnokultura dhe fenomeni i globalizimit«: "*GJAFE*", 35-2005.